KËSHILLI I EUROPËS

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

MBI PRANUESHMËRINË

ANKIMI NR. 54268/00
QUFAJ CO. SHPK KUNDËR SHQIPËRISË

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (Seksioni i tretë), e mbledhur më 2 tetor 2003, me trup gjykues të përbërë nga:

z.G.	Ress,	*President*
z.I.	Cabral	Barreto
z.P.		Kūris
z.B.		Zupančič
z.J.		Hedigan
znj.M.		Tsatsa-Nikolovska
z.K.	Traja,	*gjykatës*

z. v. Berger, *Regjistrues i seksionit*,

duke marrë parasysh ankimin e mësipërm, të depozituar më 26 korrik 1999,

duke marrë parasysh vëzhgimet e paraqitura nga pala shqiptare dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesi,

pas shqyrtimit të ankimit, vendos si më poshtë:

FAkTet

Shoqëria ankuese, "Qufaj Co. sh.p.k.", është një shoqëri me sipërmarrje australiano-shqiptare, e themeluar me vendim nr.5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 20 korrik 1992, me objekt investimin në fushën e biznesit.

Në gjykatë është përfaqësuar nëpërmjet administratorit të saj, z. Avenir Ballvora, një shtetas shqiptar i lindur më 1957, aktualisht jeton në Montauban (Francë).

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, siç janë paraqitur nga palët mund të përmblidhen si më poshtë vijon:

Me vendimin nr.165 të datës 9 qershor 1992, bashkia e Tiranës i shiti shoqërisë ankuese 15, 788 metra katrorë tokë në një zonë banimi në Tiranë.

Me anë të vendimit nr.174 të datës 15 qershor 1992, bashkia i dha shoqërisë ankuese lejen urbanistike për të planifikuar ndërtimin e pesëqind apartamenteve. Duke qenë se para se të mund të fillonte projekti, ishte e nevojshme dhe marrja e një leje ndërtimi, shoqëria ankuese i paraqiti bashkisë kërkesën përkatëse, por bashkia për një kohë të gjatë nuk arriti dot të vendoste për çështjen, duke penguar kështu punimet e ndërtimit.

Pasi Bashkia kishte refuzuar të jepte lejen e ndërtimit, shoqëria ankuese filloi procedurat në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, duke kërkuar një kompensim prej 60 000 000 lekë (në total) për humbjen. Kërkesa e saj u hodh poshtë me vendimin nr. 4064 të datës 23 qershor 1995.

Në apel, Gjykata e Apelit, Tiranë prishi vendimin e shkallës së parë dhe urdhëroi Bashkinë t'i paguante ankuesit një shumë totale prej 60 000 000 lekë (vendimi nr. 1197 i datës 23 shkurt 1996).

Në mungesë të një rekursi nga Bashkia në Gjykatën e Kasacionit, vendimi i Gjykatës së Apelit mori formë të prerë dhe u bë i ekzekutueshëm.

Më 16 korrik 1996, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në një dokument drejtuar bashkisë,

deklaroi se pas hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Civile, nuk kishte më të drejtë të fillonte një rishikim mbikëqyrës të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulta.

Më 16 korrik 1997, shoqëria ankuese i kërkoi Gjykatës së Rrethit, Tiranë, të nxirrte një urdhër për ekzekutimin e shlyerjes së kompensimit.

Më 25 qershor 1998, Gjykata e Rrethit, Tiranë hodhi poshtë një kërkesë të bërë nga bashkia për të rishikuar vendimin nr. 5492 të datës 20 dhjetor 1994 mbi themelin e çështjes, duke mos pasur bazë as në ligj, as në faktin përkatës për të vepruar në këtë mënyrë.

Më 23 korrik 1997, në dokumentin nr. 704/gj të datës 23 korrik 1997, zyra e përmbarimit njoftoi bashkinë se duhet të ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit, duke i paguar shoqërisë ankuese një shumë totale prej 60 000 000 lekësh. Megjithatë, bashkia në mënyrë të vazhdueshme refuzoi ta përmbushte këtë detyrim, duke argumentuar se nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Njëkohësisht, zyra e përmbarimit i kërkoi Arkës së Shtetit dhe Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave (institucioni kryesor financiar përgjegjës për këto pagesa) të zbatonte vendimin, duke siguruar fondet e nevojshme (neni 589, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile).

Me anë të dokumentit 2018/3 të datës 19 shtator 1997, 2018/5 të datës 7 nëntor 1997 dhe 4670 të 22 shtatorit 1999, Ministria e Financave hodhi poshtë kërkesat e zyrës së përmbarimit, duke argumentuar se neni 589 i Kodit të Procedurës Civile nuk ishte i zbatueshëm në këtë rast. Gjithashtu, edhe ligji për Buxhetin e Shtetit nuk mundësonte financimin për ekzekutimin e këtij vendimi nga buxheti qëndror. Më tej, shtohej se bashkia duhet të kontaktonte me "Distriktin e Thesarit të Degës së Tiranës", duke specifikuar fondin nga i cili duhej të paguhej borxhi dhe pjesën e buxhetit të bashkisë tek i cili duhej të alokohej.

Meqë vendimi nuk u ekzekutua, shoqëria ankuese paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se institucionet e qeverisjes vendore ishin të detyruara të garantonin zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe jo t'i pengonin ato.

Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e shoqërisë ankuese, duke deklaruar se "ankesa mund të mos merrej në konsideratë, sepse ekzekutimi i vendimeve të gjykatës është jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese".

B. Legjislacioni i brendshëm

1. Kushtetuta

Neni 42 § 2

" Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142 § 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore".

Neni 63.3

"…

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

……"

2. Udhëzimi nr. 1 i nxjerrë nga Ministria e Financave më 13 qershor 1997, sipas Aktit Financiar nr. 1 të datës 13 tetor 1997

Paragrafi 7

"Pagesat që lindin nga vendimet gjyqësore në lidhje me aktivitetin normal të institucioneve buxhetore, do të autorizohen nga kreu i institucionit qendror. Njëkohësisht, kur dëmi për të cilin shteti

është përgjegjës, është pasojë e punonjësve publikë që veprojnë *ultra vires* ose nuk janë në gjendje të veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre, kreu i institucionit qendror do të marrë masa administrative dhe do të fillojë procedime civile kundër tyre, sipas shkallës së përgjegjësisë së tyre."

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335 i datës 9 qershor 1998

Paragrafi 2 (e)

"Ministria e Financave me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e Buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen:

e) Vendime gjyqësore që përcaktojnë shprehimisht detyrimin e shtetit për arsye të tjera të parashikuara me ligj."

4. Regjistri tregtar dhe ligji i regjistrimit të kompanive nr. 7667/93

Neni 64

Riregjistrimi i shoqërive tregtare të regjistruara

"Shoqëritë tregtare të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, hollësitë dhe format e të cilave nuk përputhen me të, do të riregjistrohen jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Një kompani që nuk arrin të kërkojë riregjistrimin apo të paraqesë dokumentet e nevojshme, do të çregjistrohet automatikisht nga kjo datë e në vazhdim. Ato mund të aplikojnë për një zgjatje kohore prej tre muajsh, brenda së cilës do t'i përmbahen këtij detyrimi. Kompanitë e riregjistruara do të ruajnë të gjitha të drejtat që ato gëzonin para riregjistrimit."

5. Ligji " Për Avokatin e Popullit" (Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999)

Neni 25

Personat dhe ligjet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit do të jenë :

a) ligjet statutore dhe akte të tjera ligjore;
b) urdhrat ushtarake të Forcave të Armatosura;
c) vendimet e gjykatave.

Pa paragjykuar pikën (c) të këtij neni, Avokati i Popullit do të pranojë ankime, kërkesa, ose njoftime lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe procedurat ligjore. Hetimet e Avokatit të Popullit nuk do të prekin pavarësinë e gjyqësorit në marrjen e vendimeve.

PRETENDIMET

1. Shoqëria ankuese, bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, pretendoi se neglizhenca e autoriteteve shtetërore për të ekzekutuar vendimin e 23 shkurtit 1996, kishte penguar ushtrimin efektiv të të drejtave të saj, duke zhvlerësuar në këtë mënyrë kriteret për një gjykim të drejtë.

2. Ankuesi gjithashtu pretendoi sipas nenit 13 të Konventës, mungesën e mjeteve efektive të ankimit në legjislacionin e brendshëm për të vënë në vend të drejtat e tij. Lidhur me këtë, ankuesi i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese që refuzoi marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij duke e konsideruar jashtë juridiksionit të saj.

3. Së fundi ankuesi pretendoi shkeljen nga autoritetet shqiptare të nenit 14 të konventës, marrë së bashku me nenin 6.1, duke pretenduar se ishte trajtuar në mënyre të diferencuar nga kreditorët e tjerë në raste të ngjashme, pa asnjë justifikim.

E DREJTA

Shoqëria kërkuese ankohet bazuar në nenin 6.1, nenin 13, dhe nenin 14 të Konventës, për refuzimin e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 23 shkurt 1996. Ajo parashtron se si rezultat, nuk ka pasur mjete juridike efektive në legjislacionin e brendshëm, për të mbrojtur të drejtat e saj.

Neni 6.1 parashikon:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht..... nga një gjykatë ..... si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile....."

Neni 13 parashikon:

"Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14 parashikon si më poshtë:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

1. a) Përsa i përket nenit 6.1 të Konventes, pala shqiptare ngre dy kundërshtime paraprake:

i) Pala shqiptare pretendoi që shoqëria ankuese nuk i ka ezaururar të gjitha mjetet e brendshme efektive të ankimit. Ajo argumentoi se ankuesi nuk e ka paraqitur çështjen para Avokatit të Popullit. Gjithashtu, bazuar në ligjin nr.8812, datë 17 maj 2001, shoqëria ankuese mund ta paraqiste çështjen edhe para zyrës së përmbarimit.

Pala shqiptare ka parashtruar se ky ligj parashikon që në rast mosekzekutimi të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, zyra e përmbarimit vendos një gjobë prej 50 mijë lekësh (350 euro) ndaj debitorit sipas vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, autoritetet shqiptare pretenduan se ankuesi nuk e ka ezauruar këtë mjet të ri ankimi.

Shoqëria ankuese kundërshtoi efektivitetin e këtyre dy mjeteve juridike të ankimit, të cilave u referohet pala shqiptare. Përsa i përket institucionit të Avokatit të Popullit, ajo argumentoi se nuk mund të përbëjë një mjet efektiv ankimi, sipas kuptimit të Konventës. Më tej, ajo parashtroi se vetëm vendosja e një gjobe nga ana e zyrës së përmbarimit ndaj debitorit, nuk përmbush qëllimin kryesor të ankuesit, që është ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Për rrjedhojë, ankuesi i deklaron parashtrimet e palës shqiptare të pabazuara.

Gjykata vlerëson se rregulli për ezaurimin e mjeteve të brendshme të ankimit, sipas nenit 35.1 të Konventës, i detyron ankuesit të përdorin mjetet ligjore që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të garantohet si në praktikë, ashtu dhe në teori, përndryshe ato nuk do të ishin në dispozicion të palëve dhe do ta humbisnin efikasitetin. Neni 35.1, gjithashtu kërkon që paraqitja e ankesave në gjykatë, konform kritereve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm duhet të bëhet përpara organit të duhur vendas, por kjo nuk kërkon që çështja të adresohet me anë të mjeteve që nuk janë të përshtatshme dhe efektive. (shih Aksoy v. Turkey, no. 21987/93, §§ 51-52, ECHR 1996-VI, and Akdivar and Others v. Turkey, no. 21893/93, §§ 65-67, ECHR 1996-IV).

Përsa i përket mundësisë për t'u ankuar tek Avokati i Popullit, Gjykata vëren se Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur nga ekzekutivi, nuk mund të marrë vendime juridikisht të detyrueshme ndaj organeve shteterore (Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999). Në këtë mënyrë, ankimi tek Avokati i Popullit nuk mund të konsiderohet mjet efektiv, sipas kuptimit të nenit 35.1.

Gjykata rithekson se vërtet neni 35.1 i Konventes vendos detyrimin për ezaurimin e mjeteve të brendshme të ankimit, por kjo nuk nënkupton përdorimin e mjeteve jo të duhura dhe jo të përshtashme të ankimit (shih Valasinas v. Lithuania, no. 44558/98, 14.03.2000). Në çështjen Valasinas, Gjykata vlerësoi se peticioni tek Avokati i Popullit nuk përbën mjet efektiv ankimi, sipas kuptimit të nenit 35.1.

Përsa i përket ankimimit tek zyra e përmbarimit, gjykata vëren se shoqëria ankuese, në përputhje me ligjin nr. 8812, datë 17 .05.2001, është ankuar për refuzimin e autoriteteve ekzekutive për të zbatuar urdhërin e gjykatës dhe atë të zyrës së përmbarimit. Megjithatë, edhe një ankimim i tillë nuk do t'i mundësonte shoqërisë ankuese ekzekutimin e vendimit në favor të saj. Për më tepër,

gjykata vëren se shoqëria ankuese kishte siguruar një urdhër ekzekutimi për vendimin e datës 23 shkurt 1996, në përputhje me kërkesat e procedurës civile vendase, por zyra e përmbarimit nuk kishte qenë në gjendje ta zbatonte atë. Për rrjedhojë, gjykata konkludon se një veprim i tillë do të kishte qenë jo efektiv.

Gjykata vëren se mjetet e ankimit të cilave u referohet pala shqiptare, nuk ishin mjetet e duhura dhe të përshtatshme për të garantuar rivendosjen efektive të së drejtës që pretendohet se është shkelur. Për rrjedhojë, ky kundërshtim paraprak duhet të hidhet poshtë.

ii) Pala shqiptare pretendoi se shoqëria ankuese nuk është shoqëria që gëzon të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e vendimit. Shoqëria ankuese Qufaj sh.p.k. është regjistruar si shoqëri tregtare sipas procedurave ligjore, më 2 korrik 1992, me anë të një vendimi të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe është formuar nga Hajdar Qufaj, si president dhe z. Ballvora, si administratori dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Për më tepër, në zbatim të ligjit "Për shoqëritë tregtare" (Ligji nr. 7638/92) dhe ligjit nr.7667/93 "Për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe regjistrit tregtar", të gjitha shoqërive tregtare iu ishte kërkuar të riregjistroheshin brenda 6 muajve nga data 1 janar 1993, përndryshe ato nuk do të figuronin të regjistruara.

Në rastin konkret, sipas dokumentit të zyrës së regjistrimit të sjellë nga pala shqiptare, Qufaj sh.p.k. nuk e ka bërë riregjistrimin. Për rrjedhojë, pala shqiptare pretendoi se regjistrimi i saj është fshirë automatikisht nga regjistri.

Ashtu siç ishte përcaktuar në vendimin nr. 17 369/97 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, shoqëria ankuese nuk ishte regjistruar zyrtarisht deri në 1997. Sipas këtij vendimi, menaxhimi i shoqërisë Qufaj sh.p.k. është realizuar nga z. Ballvora si administrator dhe nga z. Qufaj si ortak.

Sipas palës shqiptare, shoqëria e re Qufaj & co sh.p.k., pala ankuese në gjykatë, nuk është e njëjta shoqëri tregtare me atë që ishte palë në procesin gjyqësor, jo vetëm nisur nga fakti që shoqëria s'ka ekzistuar zyrtarisht nga viti 1993-1997, deri në momentin kur ka bërë riregjistrimin, por gjithashtu edhe për konfigurimin e ri të administrimit të saj.

Lidhur me sa më sipër, pala shqiptare argumentoi se administratori i kompanisë nuk ka autoritet të përfaqësojë një shoqëri, e cila nuk figuron më e regjistruar, si para autoriteteve vendase, ashtu dhe para Gjykatës Europiane. Për rrjedhojë, duke qenë se shoqëria e vjetër ka pushuar së ekzistuari që nga viti 1993, shoqëria ankuese nuk mund të konsiderohet viktimë sipas nenit 34.3 të Konventës.

Ankuesi e kundërshtoi këtë argument, duke deklaruar se Gjykata e Apelit, Tiranë e kishte hedhur poshtë këtë pretendim. Për më tepër, legjislacioni, të cilit autoritetet shtetërore i janë referuar, zbatohet vetëm për shoqëritë që nuk respektonin procedurat formale të regjistrimit dhe jo për shoqërinë e ankuesit. Si rrjedhojë, regjistrimi i tij nuk kishte përfunduar siç pretendonin autoritetet shtetërore. Përveç kësaj, riregjistrimi i 1997-ës u krye si pasojë e riorganizimit të shoqërisë, për shkak të ndryshimit të rrethanave financiare të shoqërisë.

Si rrjedhojë, ankuesi argumentoi që kundërshtimi paraprak i autoriteteve shtetërore është gjithashtu i pambështetur.

Gjykata vëren se shkelja e pretenduar nga shoqëria e ankuesit ka të bëjë me neglizhencën për të ekzekutuar vendimin e 23 shkurtit 1996. Autoritetet shqiptare shpallën vendimin pasi ligjet e përmendura nga autoritetet hynë në fuqi.

Në këtë kuadër, Gjykata vlerëson se kundërshtimi primar i autoriteteve shtetërore, lidhur me mungesën e cilësive të ankuesit për t'u konsideruar si "viktimë", është i pavend, sepse faktet materiale kanë ndodhur para se detyrimi për riregjistrim të hynte në fuqi.

Përveç kësaj, duke qenë se z. Ballvora ishte dhe vazhdon të jetë administratori i të dy shoqërive, cilësia e tij për të vepruar si përfaqësues ligjor i të dy shoqërive është e pakundërshtueshme.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se edhe kundërshtimet e mësipërme duhet, gjithashtu, të hidhen poshtë.

b) Mbi themelin, ankuesi pretendoi se refuzimi i autoriteteve shtetërore për të zbatuar vendimin e datës 23 shkurt 1996 të Gjykatës së Apelit, Tiranë kishte penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së tij, duke i shndërruar në të pakuptimta kërkesat e nenit 6§1.

Autoritetet shtetërore vërejtën se vendimi i formës së prerë nuk ishte zbatuar si rezultat i rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe paqartësitë lidhur me kompetencat e autoriteteve shqiptare respektive. Gjithashtu, duke pasur parasysh kaosin ligjor dhe politik, si dhe situatën ekonomiko-shoqërore në Shqipëri, ekzekutimi i vendimit ishte krejtësisht i pamundur. Për më tepër, buxheti shtetëror ishte dhe mbetej i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjitha kërkesat lidhur me pagat, sigurimin shëndetësor, arsimimin dhe infrastrukturën.

Duke vlerësuar pretendimet e ankuesit dhe vëzhgimet e autoriteteve shtetërore, Gjykata konstaton se çështje të rëndësishme ngrihen mbi faktet dhe legjislacionin e zbatueshëm, përcaktimi i të cilave kërkon një shqyrtim në themel të çështjes. Kjo pjesë e ankimit nuk mund të konsiderohet haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35§3 të Konventës. Asnjë arsye tjetër për papranueshmërinë e saj nuk është ngritur.

Shoqëria ankuese argumentoi më tej se nuk ekzistojnë mjete të brendshme efektive për ekzekutimin e vendimit të 23 shkurtit 1996. Në këndvështrimin e saj, ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës. Në këtë kuadër, ai i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila refuzoi të merrte në shqyrtim çështjen, duke e konsideruar jashtë juridiksionit të saj.

Autoritetet shqiptare deklaruan se në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, kërkesa për "një proces të rregullt ligjor", në kuptimin e nenit 131/f të Kushtetutës Shqiptare, nuk përfshin ekzekutimin e vendimit.

Gjykata vlerëson se neni 6 §1 i Konventës merr përparësi si "lex specialis" për çështjet e mosekzekutimit të vendimeve, kështu që është i panevojshëm shqyrtimi veçmas i çështjes në kuadrin e nenit 13 (shih Jasiuniene v. Lithuania, no.41510/98, § 32, 6 mars 2003).

Në përfundim, ankuesi deklaroi se autoritetet shqiptare kanë shkelur nenin 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 6 § 1, duke qenë se neglizhenca për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit, Tiranë, erdhi si pasojë e bindjeve politike të anëtarëve të shoqërisë. Ai deklaroi se autoritetet shqiptare preferonin kreditorë të tjerë me formim të ndryshëm politiko-shoqëror.

Gjykata vlerëson se shoqëria ankuese nuk arriti të provonte pretendimin e saj që ishte diskriminuar si një kreditor privat në krahasim me kreditorët e tjerë.

Rrjedhimisht, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës, duhet rrëzuar.

Për këto arsye, Gjykata unanimisht,

Deklaron të pranueshme, pa cenuar themelin e çështjes, kërkesën e shoqërisë ankuese, lidhur me nenin 6 §1 të Konventës.

Deklaron pjesën e mbetur të ankimit të papranueshme.

Vincent BERGER — Regjistrues

Georg Ress — President